



REND DHE LIGJ

# Video/ Atentat mafioz në Durrës, plagoset prokurori Ndoja dhe dy të tjerë

19:24 - 01 Nëntor



Pamje nga atentati ne Durres, ku mbeten te plagosur 3 personave, mes tyre prokurori Arjan Ndoja. Gazeta Si

Aa Aa

Pasditen e të premtes një atentat mafioz u krye sot në mbikalimin e Shkozetit, pranë autostradës Tiranë-Durrës, duke plagosur tre personave. Sipas të dhënave të policisë atentati kishte për qëllim sulmin ndaj prokurorit të Durrësit, Arjan Ndoja.

Burime nga Policia e Shtetit konfirmuan se në ngjarjen e ndodhur në 16:30 të plagosur kanë ngelur edhe 2 të tjerë, shoferi i Ndojit dhe shoku i tij, Aleksander Laho dhe Arlind Maloku. Prokurori i Durrësit udhëtonte me mjetin ‘benz’ me targa AA 333 ZD gjatë kohës kur një automjet tjetër i është afruar dhe ka hapur zjarr. Dyshohet se shënjestër e atentatit ka qenë pikërisht prokurori Ndoj, i cili së fundi u bë ‘mollë sherri’ mes maxhorancës dhe opozitës. Makina ku ndodhej prokurori Ndoj ka dalë jashtë rruge duke përfunduar në arë.

## REND DHE LIGJ

E kërcënonte dhe gjobiste të dashurën!-Historia e trishtë një vajze të tradhëtuar

SPAK mbyll hetimin, gjyqi do të zbulojë a lidhet atentati ndaj Prokurorit Ndoja me pronat në Lalëz

Veshur bukur e shtrenjtë. Mashtruesit e hoteleve dolën me qese plehrash nga dhoma: S'kemi para, ja sa të marrim rrogën

Grabitja në Rinas, pendohet bashkëpunëtori i drejtësisë Alkond Bengasi, prish marrëveshjen me Prokurorinë

Fondet e BE për drejtësinë në Shqipëri në lupën e Gjykatës së Auditit

## KA NDODHUR

Covid-19- 655 raste të reja dhe 3 të vdekur në 24 orët e fundit

Përmbytjet, Rama-Brace: Asnjë jetë e rrezikuar, opozita akuza të dëshpëruara

7 të vdekur, 673 raste të reja me Covid-19 në 24 orë

MB: Qendrat e aplikimit për karta ID, të hapura edhe të shtunën

Aviacioni Civil i Greqisë: Të gjithë udhëtarët që futen në vend, do karantinohen 7 ditë



*Momenti i nxjerrjes te plagosurve nga makina*

Menjëherë drejt Tiranës janë dërguar tre të plagosurit, në shoqërinë e forcave të shumta të policisë. Pas informacioneve mësohet në makinë kanë qenë dy persona me precedentë penal. Andi Maloku rreth 30 vjeç, mësohet se është në gjetje të rëndë dhe është dërguar menjëherë në Spitalin e Traumës në shoqërinë e forcave të shumta policore. Maloku që mendohet se është shofer i Ndojit, ka marrë disa plumba, duke i prekur shtyllën kurrizore dhe njëri në gjoks.




*Prokurori Arjan Ndoja*

Prokurori Ndoji mësohet se ka marrë dy plumba në trup dhe së është jashtë rrezikut për jetën. Ai ndodhet në spitalin e Durrësit. Edhe Aleksandër Laho është një emër i njohur i botës së krimit. Ai njihet si i forti i Sukthit dhe mban disa emra si Landi Muharremi i njohur si “i forti i Sukthit” ose si Pëllmb Aliasi, ishte një prej personave që u akzua si i përfshirë në rrahjen barbare ndaj biznesmenit libanez, Faad Mitri. Më 10 shtator të 2016-s, Mitri u dhunua nga disa persona, të cilët e ndaluan në rrugë teksa ishte duke udhëtuar me makinë. Skena e tmerrit ndodhi në sy të familjes së biznesmenit.

“JOQ” më pas publikoi video në të cilën shfaqen se si banoët e zonës ndihmojnë

të nxjerrin të plagosurit, ku mes tyre ishte edhe prokurori Ndoja. Ndërkaq burime e para bëjnë të ditur se pritet me interes dëshmia e prokurorit dhe Muharremit dhe se mendohet se ata e kanë parë se kush e kanë qëlluar.



Video e publikuar nga “J00” nga momenti i nxjerrjes se te plagosurve

Policia nuk ka dhënë një komunikatë zyrtare për ngjarjen, porse mendohet paraprakisht se Ndoji ishte shenjëstra e këtij atentati. Në Durrësit kanë shkuar menjëherë drejtori i Përgjithshëm i Policisë, Ardi Veliu dhe prokuroria e Krimeve të Rënda, Donika Prela. Që të dy kanë shkuar në spitalin e këtij qyteti, duke kominikuar me dy të plagosurit. Policia ka nisur kërkime në zonën e Sukthit ku mendohet se janë fshehur atentatorët.

## Lajme të lidhura

- [Kur Rama e Braçe akuzonin prokurorin Ndoja në grupin "KÇK"](#)

Copyright © Gazeta “Si”

Të gjitha të drejtat e këtij materiali janë pronë ekskluzive dhe e patjetërsueshme e Gazetës “Si”, sipas Ligjit Nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Ndalohet kategorikisht kopjimi, publikimi, shpërndarja, tjetërsimi etj, pa autorizimin e Gazetës “Si”, në të kundërt çdo shkelës do mbajë përgjegjësi sipas nenit 179 të Ligjit 35/2016.

## Më Shumë



REND DHE LIGJ

[E kërcënonte dhe gjobiste të dashurën!-Historia e trishtë një vajze të tradhëtuar](#)



REND DHE LIGJ

[SPAK mbyll hetimin, gjyqi do të zbulojë a lidhet atentati ndaj Prokurorit Ndoja me pronat në Lalëz](#)



REND DHE LIGJ

[Veshur bukur e shtrenjtë. Mashtruesit e hoteleve dolën me qese plehrash nga dhoma:](#)